

Raport i Audituesit të Pavarur

(Bashkalidhur Pasqyrat Financiare te audituara)

Shoqëria "KLENSI" sh.p.k Tiranë

USHTRIMI MBYLLUR ,ME 31.12.2016

Lumturi Brahaj

Eksperte Kontabel e Autorizuar
Rr. "Aaim Vokah" pl. 13 kat.shk.25 ap.6
Tel: ++3554 2403910, cel.0692158344,
0692069881

RAPORTI I AUDITUSIT TE PAVARUR

Ortakut te vetem te shoqërise "KLENSI" sh.p.k

TIRANE.

I nderuar zoteri.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare "KLENSI", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet material pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2016, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar (SKRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. **Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.**

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport



auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditusit, përfshirë këtu edhe vlersimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vleron këto rreziqe, auditusi më në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqerte të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedurën e pershtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlersimin e pershtatshmerisë së metodave kontabel të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuararjeve kontabel të bera nga drejtimi, si dhe me vlersimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Tirane më 21.01.2017

Eksperte Kontabel e Autorizuar (lic nr.121)

Lumtur BERAHAI

Adresa

Rr. "Asim Vokshi" pll 13 katësh, shkalla 25, kati 3-te, pran Arkives Shtetit, Tirane

Tel ++355 4 2362 663, në zyrë 2 403 910 cel. 069 21 58 344.

Raporti i paraqitur është mbështetur mbi deklaratimet bashkangjitur

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
(Të gjitha balancat janë në lekë).**

1. Informacione te pergjithshme

Shoqeria "KLENSI,"sh.p.k është themeluar me date 10.03.2008 dhe është regjistruar ne QKR me date 13.03.2008.

Forma ligjore e shoqerise është. Sh.P.K.

Vlera e kapitalit te shoqerise është 170 000 000 leke e ndare ne 100 aksione me vlere nominale 1700 000 leke aksioni.

Shoqeria" KLENSI" ka nje pronare qe zoterojne 100 % te kontributit ne kapital.

Veprimtaria kryesore tregtare e sajë është e percaktuar hollesishte ne aktin e themelimit dhe ne statut.

Aktualishte ajo meret me aktivitet ndertimi.

Selia e Shoqerise është ne Tirane, ne Rr. "Frederik Shiroka"

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë).

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2016 është zbatuar formati i SKK-2 i permiruar.

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur , janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanc, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për të paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin është 15 %.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivitetet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivitetet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndertesat dhe mbi bazën e vlerës mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e perdorura janë në ndertesa 5 % të vlerës mbetur dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës mbetur.

Gjendjet e inventareve

Vlerësimi në hyrje të inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjelle inventaret në kushte magazinimi.

Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 jane si me poshte:

A	A K T I V E T	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
1	Aktive monetare	512,531	5,713,751	3,999,716

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave.

Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes se Shqiperise.

-INVESTIME

Shoqeria nuk ka investime ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit,ne aksionet e veta dhe te tjera financiare.

TE DREJTA TE ARKETUSHME

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2016 deklarohen si vijon:

A	A K T I V E T	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
	Te drejta te arketushme		154,364,449	73,726,754
	<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>	411	83,309,621	73,726,754
	<i>Nga njësitë ekonomike brenda grupit</i>		0	0
	<i>Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	445	37,811	0
	<i>Të tjera</i>	455	71,017,017	0
	<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>		0	

Ne “Llogari / *Nga aktiviteti i shfrytëzimit*” jane pasqyruar kerkesat ndaj klienteve per shitjen e mallrave .Lista e tyre analitike i bashkangjitet pasqyrave financiare.

Ne *Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse* eshte pasqyruar *atim mbi vlerene shtuar i mbi paguar.*

Ne *Të tjera* jane pasqyruar *detyrimet e ortakut ndaj shoqerise.*

Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqitet si vijon.

Vlersimi i stokut eshte bere sipas standartit ,(skk nr 4)

Shoqeria ka bere inventarin fizik te mallrave dhe disponon listat e inventarve .

A	A K T I V E T	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
	Inventari		15,081,435	17,789,699
	<i>Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		15,081,435	17,078,933
	<i>Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte</i>		0	0
	<i>Produkte të gatshme</i>		0	0
	<i>Mallra</i>	351	0	0
	<i>Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmër)</i>		0	0
	<i>AAGJM të mbajtura për shitje</i>			
	<i>Parapagime për inventar</i>	401	0	710,766

Shpenzime te shtyra

Ketu jane pasqyruar shpenzimet e shtyra ,te cilat lidhen me ndertimin e apartamenteve dhe do te kalojne ne rezultatin respektive ne momentin e shitjes se tyre per siguruar perputhjen e te ardhurave me shpenzimet .ne vitin ushtrimore eshte paksuar per koston e ndertimit te siperfaqeve te shitura.

A	A K T I V E T	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	481,486	723,210,469	839,889,188

Te Arketushme nga te ardhura te konstatuara nuk ka

Aktivet Afatgjata

Aktive financiare afatgjata nuk ka

Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendja levizjet dhe amortizimi i tyre pasqyrohen ne pasqyren e me Poshte.
Grupimi dhe vlersimi tyre eshte bere i sakte.

A	A K T I V E T	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
	Aktive afatgjata materiale		24,639,846	22,764,628
	<i>Toka dhe ndërtesa</i>		-	-
	<i>Impiante dhe makineri</i>	2134/2183	8,560,631	8,560,631
	<i>Të tjera Instalime dhe pajisje</i>	215	16,079,215	14,203,997
	<i>Parapagime për aktive materiale dhe në proces</i>		0	

Ne postin e impjante dhe Makineri eshte pasqyruar vlera e mbetur e mjeteve te punes
Ne postin –te tjera istalime dhe paisje eshte pasqyruar vlera e mbetur e mjeteve te transportit.

Vlera fillestare minus amortizimin qe pasqyrohen ne balance ne llogarit e references.
 Vlersimi i tyre eshte bere me vleren neto kontabel.
 Dhe grupimi i tyre eshte bere sipas standartit perkates te kontabilitetit.
 Amortizimi per vitin ushtrimore eshte llogaritur mbi vleren e mbetur te te aktiveve te qendrushme qe kane qene gjendje ne fillim te vitit. Norma e amortizimit e aplikuar eshte e barabarte me nomen e lejuar .

Aktive biologjike afat gjata nuk ka.

Aktive Afat gjata jo materiale nuk ka.

Aktive tatimore të shtyra nuk ka.

Kapital te pa derdhur nuk ka.

Detyrime afatshkurtera-

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2016 paraqiten si vijon:

B	PASIVET	Ref. llo g	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
	Detyrime afatshkurtra:		160,482,550	182,796,452
	Titujt e huamarrjes	455	-	11,942,724
	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë			
	Arkëtime në avancë për porosi	488		
	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	401	157,332,268	165,764,201
	Dëftesa të pagueshme			
	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit			
	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrës			
	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndet	421/431 /442	135,086	151,890
	Të pagueshme për detyrimet tatimore	444	3,015,196	4,937,637

Drejtimi mendon se te gjitha huate dhe parapagimet do te paguhet ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon rnie ne vlere.

Detyrimet ne monedhe te huaj jan vlersuar me kursin e bankes se Shqiperise te dates 31.12.2016.

Titujt e huamarrjes jane pasqyruar detyrimet ndaj ortakut per huate e dhena shoqerise.

Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit jane pasqyruar detyrimet ndaj furnitorve per furnizimet e bera .

Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.

Vlersimi eshte bere fature per fature te mbetur e pa u likujduar.

Drejtimi mendon se te drejtat e furnitorve jane te vleresuara realisht.

“Të pagueshme ndaj punonjësve“ perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit dhe detyrimet qe ka per ta ndaj shtetit per sigurime e tatim ne burim deri ne 31.12.2016.

“Detyrimet tatimore perfaqesojne detyrimin per ,tatimin mbi fitim qe lidhet me rezultatin e vitit ushtrimore 2016.

Te pagushme per shpenzime te konstatuara nuk ka.

Te ardhura te shtyra nuk ka

Provizione nuk ka

Te pagushme per shpenzime te konstatuara nuk ka.

Te ardhura te shtyra nuk ka

Provizione nuk ka

Detyrime Tatimore te shtyra nuk ka

Detyrime afat gjata

Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata jane pasqyruar detyrimet ndaj bankave si me qe i perkasin viti parardhes, Arketimet per porosi per blerje sipërfaqe ende te pa perfunduara.Ne te pagushme per aktivitetin e shfrytzimit jane pasqyruar detyrimet ndaj pronarve te truallit ne kembim te ketij detyrimi pronaret do te marin sipërfaqet per te cilat eshte rene dakort per te cilat do te pritret fature shitje sipas kontratave qe do te hartohen ne momentin e dorzimit te pronave te cilat jane regjistruar ose do te regjistrohen ne hipotek ne kembim te truallit respektive.

B	PASIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
	Detyrime afatgjata:		546,941,375	604,436,432
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>		0	
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	460	0	6,867,307
3	<i>Arketimet në avancë për porosi</i>	4091	298,067,712	433,255,028
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit Pronaret</i>	4093	248,873,663	164,314,097
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>			
6	<i>Të pagueshme ndaj njësjve ekonomike brenda grupit</i>		0	0
7	<i>Të pagueshme ndaj njësjve ekonomike ku ka interesa pjesëmar</i>		0	0

18. KAPITALI

.Kapitalet e veta.

Kapitalet e veta te shoqeris jane te barabarta me fitimet neto te realizuara plus kontributin fillestar.

B	PASIVET	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
III	KAPITALI dhe Rezervat dhe fitimi		215,586,025	170,937,101
1	Kapitali I Nenshkruar		170,000,000	124,000,000
2	Primet e lidhura me kapitalin		0	0
3	Rezerva Rivlersimi	101	0	0
4	Rezerva te tjera		937,101	769,842
	<i>Rezerva ligjore</i>		937,101	769,842
	<i>Rezerva statutore</i>		0	0
	<i>Rezerva të tjera</i>	1071	0	0
5	Fitimi i pashpërndarë	108	0	0
6	Fitim / Humbja e Vitit	109	44,648,924	46,167,259

Gjate ushtrimit kontabel ka rritje te kapitaleve te veta per fitimin e realizuar **44,648,924** leke.

19. Fitimi (humbja) e vitit financiar

- **Te ardhurat .**

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Pasqyra e Performancës			
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)			
<i>Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës</i>			
Nr	Pershkrimi i Elementeve	2016	2015
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	353,010,211	390,687,581
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme e prodhimit në proces	0	0
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	0	0
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	0	-
	Totali te ardhurave	353,010,211	390,687,581

Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe e sherbimeve te ndertimit jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.

Njohja dhe vleresimi jane bazuar ne SNK-9.

- **Shpenzimet e veprimtarise kryesore.**

Paraqitja ne pasqyrat financiare eshte bere sipas natyres se tyre.

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Referencat Nr.llog.	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
4	Materialet konsumuara, mallrat dhe sherb.	601-608	(36,912,090)	(112,407,438)
5	Kosto e punës	641-648..	-5,646,619	-9,161,223
	Pagat e personelit	641	(4,929,540)	(7,941,195)
	Shpenz. e sigurimet shoqerore dhe shend.	644	(717,079)	(1,220,028)
6	Amortizimet dhe zhvlerësimet	68...	(443,752)	(1,979,533)
7	Kosto repektive e siperfaqeve te shitura,te ndertuara.	686	-255,206,005	-206,011,768
8	Shpenzime të tjera	61-63	(2,265,696)	(6,396,453)
8	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)		-300,474,162	-335,956,415

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate paguara ose te pagueshme.

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

Gjate vitit ushtrimore 2016 jane realizuar shitje te siperfaqeve te ndertuara .Kosto e tyre eshte pasqyruar si me larte.

Taksat lokale e shpenzimet e tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Ne postin shpenzime te tjera.

Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2016 jane treguar ne pasqyren perkatese.

▪ -Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Nr.	Përshkrimi I Elementëve	Ref.llog	Viti Raportues 31.12.2016	Viti Paraardhës 31.12.2015
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT		52,536,049	54,731,166
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)		44,793	2,361,548
1	Amortizime tej normave fiskale		0	0
2	Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor		0	0
3	Gjoha,penalitet,demshperblime		44,793	2,361,548
4	Provizione qe nuk njihen		0	0
5	Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta		0	0
6	Te tjera(interesa bankare mbi 1:4)		0	0
III	PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)		-	-
IV	FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)		52,580,842	57,092,714
V	Shpenzimi i tatim fitimit-10%		7,887,125	8,563,907
VI	FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)		44,648,924	46,167,259

- Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2016 jane si me larte.
- Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem, i cili eshte rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal, analizuar ne tabelen e me sipërme:

.Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jane kryer ne perputhje me formen ligjore te tyre , ne 31 Dhjetor 2016.

.Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytzezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

Nga analiza e gjendjes dhe Performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2016 kemi nje fitim prej **44,648,924leke**.

Ose me nje norme rentabiliteti neto/te ardhurave prej 12 %.

.Shifrat krahasuese

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2016 eshte zbatuar formati i SKK-2, i cili eshte zbatuar edhe ne vitin paraardhes prandaj shifrat jane te krahasushme.

.Vijushmeria e aktivitetit

Mendoj qe vijushmeria e biznesit eshte e garantuar edhe per vitin ne vazhdim .

Argumentuar kjo me;

- *Ka emer te mire per sherbimet cilesore qe afron.*
- *Ka gjendje kesh dhe kerkesa per te arketuar per te perballuar detyrimet .*
- *Per momentin nuk ka asnje konflikt gjygsor me kreditoret.*

- *Eshte korekte ne mardhenie me shtetin.*
- *Ka realizuar nje norme rentabiliteti shume te mire.*
- *Ka investuar ne aktivet afatgjate materjale.*
- *Ka rritje te kapitaleve te veta neto.*

Auditori pasqyrat financiare dhe shenimet per pasqyrat financiare, audite e pa varur:

Lumturi BRAHAJ

Eksperte Kontabel e Regjistruar



A handwritten signature in black ink, appearing to be the name "Lumturi Brahaj", written in a cursive style.